

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RENDA, me kryetaren e trupit gjykues Valbona Musliu-Selimaj dhe sekretaren juridike, Lindita Sylejmani, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit, A.M., për shkak të veprës penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamentit për Krime të Rënda PP.I.nr.132/2016, të dt.28.02.2017, në seancën e shqyrtimit fillestar të hapur, verbale të mbajtur me dt.21.11.2017, në praninë e prokurorit të shtetit, Hivzi Bajraktari, të akuzuarit A.M. me mbrojtësin e tij H.M.sipas autorizimit, në bazë të nenit 366 të KPPK-së, me datë **22.11.2017**, mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: A.M., nga i ati M. dhe nënës S., e vajzërisë A., i lindur me ... , në fshatin D., Komuna e K., tani me vendbanim në P., lagja L., rruga "B.K.", hyrja ..., nr....., me numër personal ..., ka të kryer Shkollën Filllore, i pa punë, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: I akuzuari me dt.28.01.2016, rreth orës 23:30, ka shkuar në fshatin R. i M., Komuna e L., respektivisht në afërsi të shtëpisë ku jetonte tani e dëmtuara A.H.me familjen e saj me të cilën i akuzuari kishte bashkëjetuar një kohë, por pasi që ishin ndarë dhe më nuk bashkëjetonin, i akuzuari, me qëllim të kërcënimit dhe frikësimit ka përdorur armën në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm të armëve duke shtënë disa herë në ajër dhe te shtëpia e saj kishte lënë një letër të bardhë në të cilën edhe i kishte shkruar disa fjalë për të.

-me këtë ka kryer veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4; 7; 17; 21; 41; 42; 49; 50; 51; 52; 62; 69; dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 248, 359, 365 dhe 366 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton dënimin alternativ:

DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME KUSHT

- Dënim me **Gjobë** në shumë prej tetëqind Euro (800 €), të cilën gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi;

- Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar dhe nëse e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim, komfor nenit 46 par.3 të KPRK-së, do ti shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo njëzet euro (20 €) do ti llogaritet një ditë burg si dhe,

- I vërteton dënim me **Burgim** në kohëzgjatje prej një vit e gjashtë muaj (1,6) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej dy (2) viteve nuk kryen vepër tjetër penale.

DËNIMIN PLOTËSUES

- Konfiskohen përgjithmonë sendet e luajshme si mjete që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale si dhe sendet që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit, sipas vërtetimit mbi marrjen e sendeve të datës 29.01.2016, siç janë: 5 copë gëzhoja dhe një letër e bardhë.

- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën aq sa do të llogaritet sipas shpenzimeve përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **tridhjetë euro (30) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje të përmbartimit me dhunë.

- E dëmtuara A.H., nga fshati, R. i M., Komuna e L., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

ARSYETIM

PTH-DKR në Prishtinë, me aktakuzën PP.I.132/16, të dt.28.02.2017, ka akuzuar A.M., për shkak të veprës penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.11.2017, ku prezantuan Prokurori i shtetit, Hivzi Bajraktari dhe i akuzuari A.M. me mbrojtësin e tij H.M.sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit të akuzuarit iu dha mundësia e deklarimit të tij lidhur me akuzën e cila i vihet në barrë, i njëjti deklaroi se e ka kuptuar akuzën e ka të qartë dhe ndihet fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, këtë pranim e bëri në mënyrë të vullnetshme, pa presion e duke i ditur pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, ndjeu keqardhje për veprimet e kryera, palës se dëmtuar i ka kërkuar falje, është penduar shumë, për shkak të shqetësimit që ishin ndarë, në shenjë revolte ka shtënë, por në ajër me qëllim që mos ti shkaktojë dëm askujt, e ka kuptuar gabimin e bërë dhe premtoi se në të ardhmen më nuk do të përsërisë asnjëherë vepër penale të tillë apo të ngjashme.

Konform nenit 248 par. 2 të KPPK-së, Prokurori i shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari për veprën penale, ngase pranimi i fajësisë është në përputhshmëri të plot me provat dhe me dëshmitë që ekzistojnë në shkresat e lëndës dhe me gjendjen faktike të përshkruar dhe i propozoj gjykatës që të njëjtin edhe ta aprovojë.

Mbrojtësi i të akuzuarit, lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se pranimin i fajësisë nga i mbrojturi i tij është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me të duke ia sqaruar të gjitha parakushtet ligjore, rrethanat, përparësitë dhe benefitet e pranimit të fajësisë, i njëjti vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm e pranoi fajësinë dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim ta aprovojë ngase i njëjti është komfor dispozitave ligjore

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga i akuzuari, gjykata konform nenit 248 par. 4 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë të të akuzuarit, pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej, Gjykata nuk administroj prova por vlerësoj se në veprimet e të akuzuarit A.M., ekzistojnë të gjitha elementet qenësore

subjektive dhe objektive të veprës penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, e të cilën veprë i akuzuari e ka kryer me dashje.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, pranimin e fajësisë, pendimin e tij për veprën e kryer penale, premtimin se nuk do të përsërisë apo nuk do të kryejë ndonjë veprë penale, sinqeritetin e tij deklarues, moshës e re, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti, andaj edhe të akuzuarit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dënim me gjobë dhe në pajtim me nenin 52 të KPRK-së, edhe dënim me kusht, ku parashihi kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht, duke qenë e bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht e që është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë veprë penale.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73 par.2 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikojnë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 41 dhe 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 62 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.6, nenit 69 dhe 375 par.3 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe 453 par 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.75/17, dt.22.11.2017

Procesmbajtëse
Lindita Sylejmani

Kryetare e trupit gjykues
Valbona Musliu-Selimaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.